



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 29/2010

Prishtinë, 19. 07. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Fatmir Rexhepi,
Mursel Haljilji, Adem Grabovci, Sala Berisha – Shala, Kaqusha Jashari, dhe Zef Morina.

Munguan: Adem Salihaj, Muferra Sinik dhe Qamile Morina.

Pjesëmarrës të tjerë: Besim Zeqiri –ICO; Besnik Ramadanaj – KDI; Milazim Allshiqi,
dhe Ramadan Makolli – SP-PTK dhe Ibrahim Krasniqi konsulent.

Stafi mbështetës: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nuriye Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të datës 13. 07.2010;
3. Miratimi i Raportit me Rekomandime të Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese nr. 03/L-181;
4. Shqyrtimi i Propozim – Strategjisë për Privatizimin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës;
5. Të ndryshme

Kryetarja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 13. 07. 2010

Procesverbali i mbledhjes së 13.07. 2010 u miratua pa vërejtje.

3. Miratimi i Raportit me Rekomandime i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese nr. 03/L-181;

Kryetarja – Theksoi se Raporti me Rekomandime pas kthimit pa ndonjë vërejtje nga Komisionet e përhershme i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese nr. 03/L-181, duhet të miratohet dhe të procedohet në mbledhje plenare për lexim të dytë.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese nr. 03/L-181

4. Shqyrtimi i Propozim – Strategjisë për Privatizimin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës;

Kryetarja – tha se ne si Komision këtë Strategji e kemi shqyrtuar dy herë ku ka qenë edhe Ministri i Ekonomisë dhe Financave z. Ahmet Shala. Andaj tani ne duhet të marrim një vendim për të proceduar në mbledhje plenare me rekomandime ose pa rekomandime. Me qenë së është kërkuar nga Kryesia e Kuvendit si çështje urgjente që të procedohet para se të përfundoj sesioni pranveror.

Adem Grabovci --Tha ne duhet ta dërgojmë në Kuvend, pastaj në seancë plenare le të vendoset që të merret vendim, që në fund është organ më kompetent për vendim të rëndësishme, kur është në shqyrtim një çështje shumë e ndjeshme për zhvillimin ekonomik të vendit siç është kjo ndërmarrje publike PTK-ja

Fatmir Rexhepi -Theksoj që deri tani e kemi bërë një debate të gjithanshme në si Komisioni funksional dhe tani është më mirë të përqendrohemi në modalitetet e privatizimit, të përqindja se sa duhet privatizohet dhe të shikojmë mundësinë se si punëtorët të jenë aksionarë. Andaj shteti nëpër mes metodës të partneritetit publiko privat ta shikoj mundësinë e investimeve. Ndërsa sa i përket mjeteve kur të privatizohet PTK-ja tha se ka mjaftë fusha se ku të investohet.

Kaqusha Jashari --Kërkoj qe strategjia për privatizimin e PTK-së është diskutuar mjaftë dhe tha qe jemi informuar me shume detaje gjatë dy mbledhjeve te kaluar. Kështu që te procedohet ne seance plenare. Ndërsa për mjete e privatizimit te PTK-së theksoj që duhet një plani i biznesit mirë i planifikuar se si do të shpenzohen këto mjete dhe kërkoj qe në seance plenare kur të shqyrtohet strategjia e PTK-së, në këtë pikë duhet të përqendrohemi për të dhënë rekomandimet ne si komision funksional.

Myzejene Selmani - Tha që ne këtë strategji nuk ka vizon dhe planifikim te qartë së ka do të shkoj ky proces. Kjo më tepër është transformim i pronës kur dihet së do te privatizohet 75% e aseteve te PTK-së. Për mjete e privatizimit te PTK-së dhe te Aeroportit që është thënë që do te shkojnë ne mbulimin e shpenzimeve autostradës as këto nuk kemi plane te qartë te cekur ne strategji.

Ethem Çeku - Theksoj që nuk kemi ndonjë informacion të ri nga mbledhja e kaluar, andaj që e vetmja pika që do te duhej te diskutoje është së a duhet te nxjerrim ne si Komision, rekomande po apo jo ose ta dërgojmë strategjinë ne Kuvend që vetëm e kemi diskutuar. Prandaj kërkoj që ta nxjerrim rekomandime sepse dhe ne seancë plenare gjatë shqyrtimit të strategjisë së privatizimit të PTK-së mund ta ndihmojmë dhe orientojmë debatin, për çështjen së cili do të jetë profit i privatizimit po ashtu dhe çështjen e punëtorëve se si do ta rregullojmë punësimin e tyre, me rastin e privatizimit të PTK-së

Sala Berisha –Shala - tha që është shumë me rëndësi që në parim të gjithë po pajtohemi për privatizimin e PTK-së siç dihet gjatë fazës së tranzicionit ndërmarrjet publike nuk kanë mundur te jenë dhe të suksesshme. Theksoj format e privatizimit i kemi analizuar mirë si kanë shkuar në rajon, por është mirë te ja lemë kohës të vërtetoi se a ka qenë koha e duhur të ndodhe privatizimi. Andaj kërkoj që me një shkresë të procedohet në Kryesinë e Kuvendit që Komisioni funksionale e ka shqyrtuar, pikën të cekur me lartë.

Zef Morina- Tha që ne si Komisioni funksional nuk kemi të drejtë me ndryshuar dhe me kthyer mbrapa Strategjinë për privatizimin PTK-së. Përgjegjësia jonë është që gjate shqyrtimit të japim ide dhe sugjerime aty ku mendojmë qe mund të ndihmojmë këtë proces dhe kërkojë që Strategjia te procedohet për Kuvend pa rekomandime sepse mund te ja ulim vlerën PTK-së. Theksoje së të gjitha dilemat, vërejtjet munde t'i debatojmë gjatë seancës plenare, dhe vendimi përfundimtar i Kuvendit duhet të jetë i zbatueshëm.

Milazim Allshiqi (SP-PTK-së) - Theksoj arsyet pse nuk duhet te privatizohet PTK-ja janë duke i pasur parasysh te arriturat dhe qëndrueshmërinë financiare për 11 vite te PTK-së. Andaj kjo vërteton se kjo është një ndërmarrje publike e suksesshme dhe profitabile për buxhetin e Kosovës. Tha që ne si Sindikate e pavarure e PTK-së jemi takuar me z,Ahmet Shala Ministre i Ekonomisë dhe Financave, për çështjen e punëtorëve së kur te privatizohet PTK-ja çka do te behet me punëtorë, ai na ka thënë se do te jetë një kontrate 3 vjeçare për mos largim nga puna, por pa saktësuar mire së çka përmbanë dhe rregullin ajo kontrate brenda.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

Propozim – Strategjia për Privatizimin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës të radhitet në rend dite të seancës plenare dhe të hapet debat

5. Të ndryshme

i) Rekomandimet për BQK-në

Kryetarja– Kërkoj që të mblidhet Grupi punues më 20.07.2010 dhe të hartoj Rekomandimet për Bankën Qendrore të Kosovës – BQK.

b) Projektligjet e energjisë

Ethem Çeku- Njoftoj se pas bisedave me përfaqësuesit e USAID-it, mbledhja e radhës e Grupit punues për projektligjet e Energjisë do të mbahet më 21.07.2010.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 30

E përgatiti:

Njësia e mbështetjes së Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani